



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:153231  
Datë: 08.06.2024  
Numri i dokumentit: 05798313

**P.nr.452/2021**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal**, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale kundër të pandehurës S.K, nga Gj, për shkak të veprës penale „Asgjësimit apo dëmtimit i pasurisë” nga neni 321 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm nën shenjë PP/II.nr.1186/2021 të dt.12.07.2021, pas mbajtjes së seancës fillestare me datë 23.05.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Pejë, Ermal Demhasaj, të pandehurës S. K dhe përfaqësuesit të saj sipas autorizimit Av. Naser Husaj nga Peja dhe, me datë 23.05.2024 morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 08.06.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**E pandehura**

**S.K** nga i ati S dhe nëna F e vajzërisë M, e lindur me datë ..... në Gj, me vendbanim në rr., .....”( afër.....) ,Gj, e pa arsimuar, amvise, e ....., i gjendjes së dobët ekonomike, identifikohet sipas L. Njoftimit me nr. personal ..... të lëshuar nga MPB të R. Kosovës, shqiptare, shtetase e R. Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTORE**

**Sepse,**

Me datë 22.05.2021, rreth orës 12:00, në fsh. V....., K Pejë, me dashje e dëmton dhe e bën të pa përdorshme pasurin e të dëmtuarit M.K, në atë mënyrë që pasi kunati i të pandehurës, këtu i dëmtuari M e kishte njoftuar të pandehurën, se bashkëshorti i saj E.K kishte shkuar në ..... dhe se nga ajo ditë e kishte lëshuar të pandehurën, kjo e fundit në shenjë revolte thyen gjësendet e ndryshme si: derën e shtëpisë, Televizionin, mjetet e amvis nisë ,furnelën, xhamin e dritares, dy llustera, vazo të luleve në sallon si dhe disa elemente në banjë ku si pasojë e kësaj të dëmtuarit i shkakton dëme materiale në vlerë prej 500 euro.

- me çka ka kryer veprë penale „Asgjësimit apo dëmtimit i pasurisë” nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Andaj, konform nenit 2, 4, 7, 21, 69, 70, 81, 82 nenit 321 par.1 të KPRK-së, nenit 364, 365, 452 par.1 të KPP-së, gjykata të pandehurës i shqipton :

### VËREJTJE GJYQËSORE

- I.** Të pandehurës Sose Kosovari i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën veprë penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do të shqiptojë sanksion më të rëndë penal.
- II.** E pandehura obligohet të paguaj e shpenzimet e procedurës dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej **20 € (njëzetë euro)**, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- III.** E pandehura obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej **20 € (njëzetë euro)**, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- IV.** Obligohet e pandehura S.K që të dëmtuarit M. K nga fshati T, Komuna Pejë, t’ia paguaj shumën prej **500 euro** në emër të dëmit të shkaktuar dhe atë në pesë (5) këste të barabarta, në afat prej pesë (5) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë nën shenjën PP/II.nr.1186/2021 me dt.12.07.2021, kundër të pandehurës S ( S ) K nga Gj, për shkak të veprës penale „Asgjësimit apo dëmtimit i pasurisë” nga neni 321 par.1 të KPRK-së

Gjykata, konform nenit 240 të KPPRK-së, mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 23.05.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurës S.Ki dhe mbrojtësit të saj av. Naser Husaj nga Peja, të caktuar sipas detyrës zyrtare konform nenit 57 par.1 nën par.1.2 pika.1.2.2 të KPPRK-së.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurën në të drejtat e saj.

Në këtë rast pasi gjykata, e ka udhëzuar të pandehurën për kushtet, natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë me ç ‘rast e pandehura ka deklaruar se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe pa kurrfarë presioni e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, Prokurori i Shtetit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë për veprën penale për të cilën akuzohet pasi ky pranim mbështetet në provat materiale nga shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të pandehurës lidhur me pranimin e fajësisë nga e pandehura deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë.

Gjykata duke vepruar konform nenit konform dispozitave të nenit 322 lidhur me nenin 242 par. 2 dhe 6 të KPPRK-së, është bindur se e pandehura e kuptoj natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit dhe pasi pranimi i fajësisë është bërë si rezultat i vullnetit të plotë të pandehurës, pa presion apo ndikim miratoj pranimi i fajit pasi ky pranim mbështetet në provat materiale nga shkresat e lëndës respektivisht aktakuza siç janë: Raporti i policit Fikret Eroviç me nr te rastit 2021-DA-0720, raporti i policit Xhevdet Shala me nr te rastit 2021-DA-0720, deklaratat e të dëmtuarit – dëshmitarit M.K e dhënë me datë 22.05.2021 në St.Policor në Pejë, deklaratat e të pandehurës S K e dhënë me dt.23.05.2021 në St.Policor në Pejë dhe foto dokumentacioni.

Prokurori i shtetit i propozoi gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethanë rënduese të merret parasysh ndonjë dënim eventual i mëhershëm.

Mbrojtësi i të pandehurës i propozoi gjykatës që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, gjendja e dobët ekonomike e të pandehurës si dhe faktin se i njëjta është në pritje të një fëmije.

E pandehura në fjalën përfundimtare i propozoi gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit për të si rrethanë lehtësuese të merret parasysh pranimin e fajësisë, veprimet e bëra kanë qenë momentale dhe i premtoi gjykatës se nuk do ta përsërisë veprën penale.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike, siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurës S.K, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale „Asgjësim apo dëmtim i pasurisë” nga neni 321 par.1 të KPPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurës dhe e njëjta është penalisht përgjegjëse. Sa i parket fajësisë e pandehura ishte e vetëdijshme për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPPRK-së. Kështu si rrethana veçanërisht lehtësuese për të pandehurin gjykata mori pranimin e fajësisë, shprehjen e pendimit për veprën e kryer si dhe gjendjen e saj të dobët ekonomike. Ndërsa, rrethana rënduese gjykata për të pandehurën nuk gjeti asgjë.

Sipas bindjes së gjykatës, vërejtja gjyqësore e shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është e drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurës. Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me shqiptimin e vërejtjes gjyqësore si qortim për të pandehurën është i mjaftueshëm dhe në këtë rast mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 81 i KPRK, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën dhe kryesin, vërejtja gjyqësore është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e saj në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një sanksion i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurës që e njëjti në të ardhmen të përmbahet nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, nenin 450, 452 paragrafi 1 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në të cilat të pandehurit obligohen t'i paguajnë brenda afatit të përcaktuar si më lartë, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 462 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së, vendosi si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal**  
**P.nr.452/21, me datë 08.06.2024**

**Bashkëpunëtore profesionale**

**Gjyqtare e vetme gjykuese**

\_\_\_\_\_  
Gylaj Nepola

\_\_\_\_\_  
Ilda Cucović Sahatçiu

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.